

LIGJ
Nr.8338, datë 30.4.1998

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7777, DATË 22.12.1993 "PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" NDRYSHUAR ME LIGJET NR.7788, DATË 9.2.1994; NR.7852, DATË 27.9.1994; NR.7899, DATË 2.2.1995 DHE NR.8101, DATË 28.3.1996

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr.7491, datë 20.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë" ndryshuar me ligjet nr.7788, datë 9.2.1994; nr.7852, datë 27.9.1994; nr.7899, datë 2.2.1995 dhe nr.8101, datë 28.3.1996, neni 3 ndryshohet si vijon:

"Në taksat lokale bëjnë pjesë:

1. Taksat e bashkisë dhe të komunës:
 - 1.1 taksa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme;
 - 1.2 taksa e pastrimit dhe e largimit të mbeturinave;
 - 1.3 taksa e fjetjes në hotel të të huajve;
 - 1.4 taksa e tregut për zënie vendi;
 - 1.5 taksa e xhiros për restorante, diskoteka, hotele, kafene, bar-bufe e pastičeri;
 - 1.6 taksa e reklamës;
 - 1.7 taksa e tabelës;
 - 1.8 taksa për çdo bagti të therur;
 - 1.9 taksa për shfrytëzimin e lendës drusore në pyjet prone e komunave;
 - 1.10 taksa regjistrimi për ushtrimin e lotarive, konkurseve parashikuese dhe lojërave të fatit me karakter lokal;
 - 1.11 taksa për mbajtjen e qenve të luksit;
 - 1.12 taksa regjistrimi për vendbanimin e ri;
 - 1.13 taksa e parkimit të automjeteve.
2. Taksat e rrethit:
 - 2.1 taksë gjuetie dhe peshkimi amator;
 - 2.2 takse për ndërtime të reja.

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si vijon :

"Këshilli i bashkisë dhe i komunës, kur e gjykon të domosdoshme, mund të vendosë taksa me karakter të përkohshëm për shërbime të reja në interes të banorëve të territorit që mbulon. Të tilla taksa mund të vendosë edhe këshilli i rrethit, pasi të ketë marrë më parë miratimin e këshillit të bashkisë ose të komunës, në të cilat ofrohet ky shërbim.

Neni 3

Në nenin 7, pika "Për taksat lokale" ndryshohet si vijon :

"a) Taksa e regjistrimit për veprimtari të ndryshme caktohet si vijon:

1. për veprimtari private të personave fizikë që merren me tregti dhe kryejnë shërbime

ambulante - 2.000 lekë;

2. për personat fizikë e juridikë, shtetërorë e privatë, vendas a të huaj - 20.000 lekë.

b) Taksa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave caktohet:

1. Për çdo familje - 300 lekë në vit.

2. Për çdo njësi tregtare:

2.1 për bulmet, mish, peshk - 15.000 lekë në vit;

2.2 për fruta, perime, ushqimore - 10.000 lekë në vit;

2.3 për artikuj industrial - 5.000 lekë në vit.

3. Për bare, restorante, kafene, bar-bufe, diskoteka, lojëra fati etj. - 15.000 lekë në vit.

4. Për hotele, motele, komplekse turistike - 500 lekë për çdo dhomë në vit.

5. Për konvikte, pensione, shtëpi pushimi, shtëpi fëmijësh, spitale, maternitete për çdo dhomë:

5.1 shtetërore - 20 lekë në vit;

5.2 private - 500 lekë në vit.

6. Për mjedise administrative (zyra, salla mbledhjesh etj.) për çdo dhomë:

6.1 shtetërore - 50 lekë në vit;

6.2 private - 250 lekë në vit.

7. Për institucionet kulturore e sportive:

7.1 për institucionet social-kulturore - 10 mijë lekë në vit për çdo njësi;

7.2 për institucionet sportive dhe ekspozitat e panairit e ndryshme - 20.000 lekë në vit për çdo

njësi.

Përfshihen nga taksa e pastrimit të gjitha institucionet shkollore dhe konviktet e tyre

8. Për çdo njësi shërbimi e artizanati:

8.1 kur veprimtaria klasifikohet si biznes i vogël - 5.000 lekë në vit për çdo njësi;

8.2 kur veprimtaria klasifikohet me TVSH - 20.000 lekë në vit për çdo njësi.

9. Për çdo njësi prodhimi:

9.1 kur veprimtaria klasifikohet si biznes i vogël - 15.000 lekë në vit për çdo njësi;

9.2 kur veprimtaria klasifikohet me TVSH - 50.000 lekë në vit për çdo njësi.

10. Për subjekte ndërtimi - 60.000 lekë në vit për çdo njësi.

11. Për gjithë personat që klasifikohen si ambulantë - 1.500 lekë në vit.

Të ardhurat e krijuara nga taksat e pikës "b" përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë vendosur këto taksa.

c) Taksa për fjetjen në hotel të të huajve caktohet në masën 10 për qind mbi çmimin e fjetjes. Kur në çmimin e fjetjes përfshihet edhe mëngjesi, ky i fundit zbritet nga vlera.

ç) Taksa e tregut për zënie vendi caktohet

1. Ditore:

1.1 për fruta, perime, vezë - 40 lekë për metër katror të zënë në ditë;

1.2 për bulmet, mish, peshk - 50 lekë për metër katror të zënë në ditë;

1.3 për artikuj industrial - 30 lekë për metër katror të zënë në ditë.

2. Për zënie vendi me karakter të përhershëm, bashkitë e komunat mund të organizojnë ankande të hapura për subjektet e interesuara, duke marrë si çmime bazë vlerat e përcaktuara në pikën 1 të shkronjës "ç" të këtij neni, për një periudhë jo më pak se një muaj dhe jo më shumë se një vit.

d) Taksa e xhiros për restorante, kafene, bar-bufe, diskoteka, hoteleri e pastičeri caktohet në masën 1 për qind të xhiros vjetore të kryer nga çdo njësi.

dh) Taksa e reklamës caktohet:

1. Për reklama të zakonshme:

- për Tiranën - 11 000 lekë për metër katëror në vit,

- për bashkitë e kategorisë së parë - 10 000 lekë për metër katëror në vit, dhe

- për bashkitë e kategorisë së dytë, të tretë dhe të katërt, si dhe komunat e kategorisë së parë, të dytë e të tretë - 5.000 lekë për metër katëror në vit.

2. Për reklama elektronike - 20.000 lekë për metër katëror në vit.

e) Taksa e tabelës caktohet:

1. Për tabelat e shkruara në gjuhën shqipe:

1.1 për personat fizikë e juridikë - 500 lekë në vit.

2. Për tabelat e shkruara në gjuhë të huaj caktohet trefishi i vlerave të përcaktuara në pikën 1 të shkronjës "e".

- d) Taksa për çdo bagëti të therur në vendet e caktuara nga komuna a bashkia caktohet:
1. Për bagëti të trasha e derra - 50 lekë për kokë të therur;
 2. për të imtat - 20 lekë për kokë të therur.
- f) Taksa për shfrytëzimin e lëndëve drusore në pyjet që janë pronë e komunave caktohet me ligj.
- g) Taksa e regjistrimit për ushtrimin e lotarive, të konkurseve e parashikuesve të lojërave të fatit me karakter lokal caktohet - 5.000 lekë në vit.
- gj) Taksa për mbajtjen e qenve të luksit caktohet 10.000 lekë në vit me dhënien e certifikatës përkatëse.
- h) Taksa e regjistrimit për vendbanimin e ri caktohet për çdo familje :
1. në Tiranë - 5.000 lekë/regjistrim;
 2. në rrethe të kategorisë së parë - 3.000 lekë/regjistrim;
 3. në rrethe të kategorisë së dytë - 2.000 lekë/regjistrim.
- i) Taksa e gjuetisë dhe peshkimit amator - 1.500 lekë në vit për çdo leje të dhënë.
1. Taksa për ndertime të reja caktohet - 15 lekë për metër katëror mur i jashtëm për çdo ndërtesë të re, sipas projektit të miratuar gjatë marrjes së lejes së ndërtimit.
11. Masa e taksës për parkimin e automjeteve për një orë caktohet:

	Bashkia Tiranë	Bashkitë e Kateg. I-II	Bashkitë e Kateg. III-IV dhe komunat me qytete
1. Autobuzat e të gjitha llojeve	100 lekë	50 lekë	30 lekë
2. Mikrobuzat			
* Autotaksi 8-10 vende	20	20	15
* Minibuze të tjera të çdo lloji	30	20	15
3. Autoveturat			
* Taksi	20	10	10
* Shtetërore dhe private	10	10	10
4. Kamionë			
- deri 3,5 ton	10	10	10
- mbi 3,5 deri 8 ton	15	15	15
- mbi 8 deri 14 ton	20	20	20
- mbi 14 ton	50	25	25

Neni 4

Në nenin 8, shkronja "B", nënpika "a" ndryshohet si vijon:

1. Për taksën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave 5 për qind - nënpika, "c" ndryshohet si vijon:

"Për taksën e gjuetisë dhe peshkimit amator 5 për qind". - Shtohet nënpika "1" me këtë përmbajtje:

"Për taksën për mbajtjen e qenve 5 për qind".

Në nenin 8, shkronja "B" "Për taksat lokale" ku përcaktohen organet për nxjerrjen e taksave të gjiltha nënpikat e pikes "B" ndryshohen si vijon.

"a) Për taksën e fjetjes në hotel të të huajve ngarkohen hotelet, pensionet shtetërore ose private të nxjerrin vlerën e saj dhe, mbi bazën e bashkërendimit me sektorin përkatës të organit të pushtetit lokal, të derdhin detyrimin në buxhetin lokal jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës.

b) Për taksën e pastrimit dhe të largimit të mbeturinave caktohen degët e shitjes së energjisë elektrike në rrethe të bëjnë vjeljen e saj. Bashkia ose komuna në fillim të çdo viti dërgon pranë kësaj dege listën e plotë të subjekteve që janë objekt i kësaj takse, si dhe masën e taksës për çdo subjekt, Dega e shitjes së energjisë elektrike bën vjeljen e taksës mbi bazën e këtyre listave njëherësh për gjithë vitin, por jo më vonë se tremujori i parë i çdo viti. Shumat e ngarkuara derdhen në degen e thesarit të

rrethit, për llogari të buxhetit lokal përkatës. Dega e thesarit bën ndarjen: 95 për qind ia kalon buxhetit lokal të bashkisë a komunës dhe 5 për qind e kalon në favor të degës së shitjes të energjisë elektrike.

c) Për taksën e tregut për zënie vendi caktohen bashkia ose komuna, ku kryhet veprimtaria, të bëjë vjeljen e taksës. Agjenti ose organi i caktuar nga komuna a bashkia përcakton dhe vjel taksën kundrejt biletës për çdo subjekt në raport me sipërfaqen e zënë, duke e derdhur atë çdo ditë në arkën e bashkisë ose komunës.

Në rastet kur zbatohet zënie vendi me karakter të përhershëm (një muaj deri në një vit), organizohet ankandi i hapur me subjektet që janë të interesuara për të tregtuar në vendet e caktuara, duke marrë për vlerë fillestare çmimet ditore të përcaktuara më sipër dhe fituesve u bëhet vlerësimi i taksës së vendit, sipas vlerës përfundimtare ditore të shumëzuar me numrin e ditëve, për të cilën është kryer ankandi. Pagesa në këtë rast u bëhet inspektorëve ose agjentëve tatimorë të caktuar nga bashkia a komuna me prenotim, jo më pak se një herë në muaj, në fillim të çdo muaji. Me këtë rast bashkia a komuna lidhin kontratë me subjektin fitues.

Për taksën për gjueti dhe peshkim amator caktohet shoqata e gjuetarëve dhe peshkatarëve, e cila bën arkëtimin e taksës në çastin e dhënies së lejes të ushtrimit të gjuetisë ose peshkimit amator. Këto shuma derdhen pastaj në degën e thesarit, e cila bën kalimin e taksës së vjelur në buxhetin e organit të pushtetit lokal dhe nga e cila 5 për qind të vlerës ia kalon shoqatës përkatëse.

d) Për taksën e tabelës ngarkohen bashkitë e komunat të bëjnë vjeljen e saj për subjektet që e kryejnë veprimtarinë e tyre në territorin e bashkisë ose komunës. (Çdo subjekt që i nënshtrohet kësaj takse, është i detyruar të vendosë tabelën e emërimit të vet në objektin ku kryen veprimtarinë e tij dhe të paguajë detyrimin e përcaktuar pranë bashkisë a komunës brenda muajit janar të çdo viti.

Përfshihen nga kjo taksë vetëm subjektet që kryejnë veprimtari ambulatorë.

dh) Për taksën e mbajtjes së qenve ngarkohet zyrat e veterinarisë në bashki e komuna, të cilat bënë vjeljen e taksës, me dhënien e certifikatës përkatëse.

e) Për taksën e ndërtimeve të reja ngarkohen zyrat e urbanistikës të bëjnë përcaktimin e saj sipas objektit të miratuar me dhënien e lejes së ndërtimit. Shuma derdhet në degën e thesarit, e cila bën kalimin e saj në buxhetin e organit që ka bërë miratimin e lejes së ndërtimit.

ë) Për taksën e regjistrimit për veprimtari të ndryshme ngarkohen degët e tatimeve e të taksave në rrethe që në çastin e regjistrimit të subjektit pranë tyre, të llogaritin dhe të arkëtojnë detyrimin e përcaktuar për llogari të organit të pushtetit lokal (bashkisë ose komunës përkatëse). Kjo taksë paguhet një herë në çeljen e veprimtarisë ekonomike.

f) Për taksën 1 për qind të xhiros bashkitë a komunat bëjnë llogaritjen e saj për çdo subjekt që i nënshtrohet kësaj takse, mbi bazën e xhiros vjetore nga kasat regjistruese. Në pamundësi për të marrë të dhënat nga kasat për shkaqe objektive, rezultati nxirret nga masa e tatimit paraprak të përcaktuar nga degët e tatimeve e taksave në rrethe, sipas raportit të ndarë në përqindje. Subjektet, me marrjen e njoftimit, për detyrimin që kanë për taksën e 1 për qind të xhiros, bëjnë likuidimin e saj pranë bashkisë ose komunës që u ka caktuar masën e detyrimit fiskal çdo tremujor, por jo më vonë se data 15 e muajit pasardhës.

g) Për taksën e regjistrimit familjar në vendbanimin e ri, çdo kryefamiljar, me ndryshimin e vendbanimit, është i detyruar të paraqitet pranë zyrës së gjendjes civile të bashkisë a komunës, ku përfshihet vendbanimi i ri, për të bërë pagesën e taksës së mësipërme. Punonjësi i gjendjes civile pajis kryefamiljarin me dokument që vërteton pagesën e kryer.

gj) Për taksën e reklamës ngarkohen bashkitë e komunat ta vjelin atë nga subjektet që vendosin reklamat brenda territorit të tyre.

h) Për taksën e parkimit të automjeteve ngarkohen bashkitë dhe komunat.

i) Për taksën për çdo bagëti të therur ngarkohen komunat dhe bashkitë.

Në raste të veçanta këshillat e rretheve, bashkive dhe komunave kanë kompetencë të tyre të caktojnë edhe subjekte të tjera jashtë atyre të përmendura më sipër, shtetërore a private, fizike e juridike, të bëjnë vjeljen e taksave lokale që ato kanë në kompetencë të drejtpërdrejtë për t'i vjelë. Në këto raste subjekteve që do të shërbejnë si agjentë tatimorë, u lihet deri 11 për qind e shumës së arkëtuar, duke kryer me parë ankand të hapur me ato subjekte ose persona që janë të interesuar për të bërë vjeljen e taksave lokale. Kufi maksimal në këtë rast do të shërbejë niveli 11 për qind. Me përcaktimin e agjentit tatimor që do të vjelë taksat lokale, rrethi bashkia a komuna lidh kontratën për vjeljen e taksave.

Neni 5

Neni 11 ndryshohet si vijon:

"Shkeljet e parashikuara në nenin 10 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga inspektorët e ngarkuar për kontrollin e vjeljen e taksave nacionale dhe lokale nga 5.000 lekë deri 10.000 lekë, duke marrë edhe vlerën e plotë të taksës.

Organi ekzekutiv i pushtetit lokal që përfiton nga taksa, ka gjithashtu të drejtë të urdhërojë:

1. Në rastet kur nuk paguhet taksa e pastrimit, pezullohet veprimtaria private dhe vendoset sekuestri deri në vlerën e taksave të papaguara. Për familjet që janë në marrëdhënie pune, lajmërohet institucioni ku punon taksëpaguesi dhe i ndalohet paga deri në vlerën e taksës së papaguar.

2. Largimin forcërisht nga vendi të personave që nuk paguajnë taksën e tregut.

3. Pezullimin e veprimtarisë për personat që nuk paguajnë taksën e reklamës, taksën e tabelës, taksën e regjistrimit të veprimtarive të ndryshme, taksën 1 për qind të xhiros etj.

4. Të pezullojë veprimtarinë, nëse ka vonesë në likuidimin e taksës së fjetjes në hotel të të huajve, të mbyllë hotelin dhe të vendosë sekuestrin në vlerën e taksës së papaguar.

5. Të bëjë sekuestrimin e mishit të therur për mospagim të taksës së therjes.

6. Të hiqet leja e gjuetisë dhe e peshkimit në rastet kur nuk paguhet taksa e gjuetisë dhe peshkimit amator.

7. Nëse nuk paguhet taksa për ndërtime të reja, nuk jepet leja e ndërtimit të objektit.

Në rast përsëritjeje të zbatohen dispozitat e ligjit nr.7967, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative".

Neni 6

Ligji nr.8101, datë 28.3.1996 "Për një ndryshim në ligjin nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohet.

Në lidhjen nr.4 të ligjit nr.7777, datë 22.12.1993 "Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë", në pikën "E" "Taksa e akteve dhe e pullës", nën-pika "3" "Për regjistrimin përfundimtar të vendbanimit të ri", hiqet.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2087, datë 12.5.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani